

Pajazit Nushi, **FJALA E HAPJES SË AKADEMISË**

Kam nderin që, në emër të Këshillit organizues, të hap këtë akademi kushtuar 60-vjetorit të lindjes së personalitetit të shquar të shkencës dhe kulturës shqiptare, akademik Rexhep Qosja.

Me këtë rast përshëndes të gjithë të pranishmit në këtë akademi, veçanërisht zotin Idriz Ajeti, Kryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, akademik Rexhep Qosja dhe anëtarët e familjes së tij.

Shënimi i përvjetorit të lindjes së krijuesve të mëdhenj, sikurse është Rexhep Qosja, është pjesë e kulturës dhe e zhvillimit të saj në mjedisin e tyre. Midis krijues i Rexhep Qosjes është hapësira e gjerë gjithëshqiptare dhe horizonti kulturor i gjithë Evropës e më gjerë. Për këtë shkak organizuesit e kësaj akademie, Instituti Albanologjik i Prishtinës dhe Forumi i Intelektualëve Shqiptarë, insistuan në mbajtjen e saj edhe përkundër kërkesës së Rexhep-it se nuk është koha e mbajtjes së akademive të këtilla.

Zonja e zotërinj,

Krijuesit e mëdhenj, me mendimin krijues dhe me erudicionin e tyre kanë shqetësuar përherë epokën e tyre, duke i dhënë kuptim e frymë të veçantë rrjedhës së historisë njerëzore. Me vlerat e krijimieve të tyre këta obligojnë brezat e sotëm dhe të ardhshëm.

Edhe në këtë kohë dramatike të historisë sonë kombëtare, vepra shkencore, letrare dhe publicistike e Rexhep Qosjes na obligon për nderimin e veçantë, sepse është vlerë e çmueshme në visarin tonë kombëtar, me të cilën do të krenohej çdo komb i qytetëruar. Sepse ata që e njohin mirë vetveten, mund ta njohin edhe botën. Ata që i respektojnë vlerat e veta, i respekton edhe bota.

Rexhep Qosja është ndër fenomenet e shquara të kulturës shqiptare. Ky me profilin e tij shkencor, letrar e publicistik ka krijuar figurën poliedrike të rilindasit të madh shqiptar të kohës sonë.

Gjatë 30 viteve të veprimtarisë krijuese, Rexhep Qosja ka emancipuar thellësisht vetëdijen kombëtare për identitetin shpirtëror e kulturor, për të vërtetën historike e shkencore, për tragjikën dhe idealet kombëtare. Kështu ai i hapi mendësisë dhe kulturës shqiptare gjatë kohës së monizmit, sidomos pas kësaj kohe, vizionin e madh evropian të lirisë dhe të demokracisë.

Me veprën publicistike të Rexhep Qosjes, mendimi politik shqiptar dhe mendimi politik për shqiptarët mori përmasa të reja, ndërsa çështja jonë kombëtare përmasa ndërkombëtare.

Mendimi politik e racional i Rexhep Qosjes është shprehje specifike e vetëdijes përherë të zgjuar për të parë realitetin pa maska; për të parë se ku gjendemi sot dhe ku duhet përqëndruar energjinë kombëtare për të qenë të lirë e sovran në vendin tonë nesër.

Duke shkruar për porosinë e madhe të Naim Frashërit, Rexhep Qosja ka shqiptuar fuqimisht edhe porosinë e tij për bashkimin kombëtar si domosdoshmëri historike.

Në gjashtëdhjetëvjetorin e lindjes i shprehim nderim të posaçëm veprës së tij në emër të organizuesve të kësaj akademie dhe të të gjithë jush duke i uruar shëndet të mirë dhe krijimtari të frytshme në të ardhmen.